



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 3392 prot.

Gramsh, më 21/08 /2026

Njoftim për Thirrjen e Mbledhjes së Radhes të Këshillit Bashkiak

Të nderuar Këshilltarë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar neni 53 pika 3 germa a), Rregullores “Për funksionimin e Këshillit” neni 57 pika 1 gërma a), njoftoj se mbledhja e radhës e muajit GUSHT do të zhvillohet ditën e PREMTE datë 28/08/2026 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit me rend dite si më poshtë:

- 1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Korrik 2026 (fondi 6%).
(Sek.Ndihmës Ekonomike)
- 2- Për miratimin e disa ndryshimeve në VKB nr. 105 datë 29.12.02025 “Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2026”
(Dr. e Financës)
- 3- Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Gramsh dhe Shoqërisë AIROI SH.K.P për zhvillimin e projekteve të ripyllëzimit , restaurimit ekologjik dhe sekuestrimit të karbonit.
(Kryetari)
- 4- Për kalimin në fond banese të objektit “Ish Ndërmarrja e Shqopave” pasuria Nr. 7/97 Zona Kadastrale 1842, në pronësi të Bashkisë Gramsh, për qëllime strehimi dhe privatizimi.
(Sektori administrimit të pronave publike)
- 5- Për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit Aleksandër Toçila.
(Dr. e Financës)
- 6- Kërkesa të qytetarëve ; Të tjera

Duke ju falenderuar!

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH
Kryesia

Nr. 3396 prot.

Gramsh, më 21/08/2026

VENDIM

PËR
MIRATIMIN I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore ”, neni 17,56, 57 dhe “Rregulloren për Organizmin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Gramsh”, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e datës 18.08.2026:

VENDOSI

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës për **muajin Gusht** të Këshillit të Bashkisë Gramsh, e cila do të mbahet në **datën 28.08.2026 ora 10:00** në sallën e mbledhjeve.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Gramsh, Deputetët e qarkut dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Xhulia GJINI



Kryetari i Këshillit Bashkiak
Enis ZANI